

Arrestohet një i dyshuar, mbajti me zor ish-bashkëshorten dhe fëmijët në fshatin Sferkë



Një person është arrestuar në Klinë për dhunë në familje dhe mbajtje të paautorizuar të armëve.

Sipas njoftimit nga Policia të martën, fillimisht është pranuar informacioni se një shtetase austriake së bashku me dy vajzat e saj, është duke u mbajtur pa dëshirën e saj nga ish- bashkëshorti në shtëpinë e tij në fshatin Sferkë të Klinës, i cili po ashtu dyshohet se posedon armë zjarri.

Bëhet e ditur se Policia menjëherë ka dalë në vendngjarje, ka arrestuar personin e dyshuar, ndërsa viktima së bashku me vajzat e saj janë shoqëruar në stacionin policor në Klinë.

Viktima pas intervistimit është dërguar në shtëpinë e sigurt, ndërkaq i dyshuari është dërguar në mbajtje për 48 orë.

“Gjatë bisedës me prindin e të dyshuarit, i njëjti ka pranuar se posedon një armë: 1. armë AK 47, 1. karikator të së njëjtës armë dhe 43 copë fishekë të calibrit: 7.62x39mm. Arma është sekuestruar nga hetuesit. I dyshuari, për rastin e armës pas intervistimit me vendim të Prokurorit të shtetit është liruar në procedurë të rregullt”, thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#ARRESTIM

Caktohet seanca e shqyrtimit gjyqësor kundër Dardan Krivaqës e Arbër Sejdiut

Pesë të lënduar nga një aksident në fshatin Zhabar

Vrasje në tentativë ndaj tre policëve në Prizren

Vrasje në tentativë në Prishtinë

Arrestohet një i dyshuar për keqpërdorim të fëmijëve në pornografi

Një person në Prishtinë raporton se është rrëmbyer për shkak të borxhit

Sulmohet një infermier në Onkologji, reagon Sindikata

11 tetor 2022, 11:15

Shpërndaje në



TË TJERA




Digjet një veturë në rrugën Mitrovicë – Prishtinë



Nxënësi ther shokun e klasës në gjimnazin “Ahmet Gashi”



Në Prishtinë arrestohet një person i kërkuar nga Austria



Policia konfirmon të shtënat para MI-së, personi me motoçikletë shtiu në një veturë